



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

NJOFTIM PËR SHTYP

Shërbimi Informativ i Shtetit publikon Raportin e dytë Publik

Tiranë, 15 qershor 2020

Shërbimi Informativ i Shtetit publikoi sot Raportin Publik 2019, që përqendrohet te prioritetet, sfidat, arritjet e problematikat e vitit 2019, si dhe objektivat për të ardhmen. Raporti, që publikohet për të dytin vit radhazi, i jep lexuesit përmbledhjen e veprimtarive që kryen SHISH-i, si institucion i angazhuar në garantimin e sigurisë kombëtare.

Publikimi i Raportit Publik 2019 i shërben zbatimit të strategjisë së SHISH-it për të qenë i suksesshëm në përmbushjen e misionit. Pjesë e kësaj strategjie është një transparencë më e madhe dhe bashkëpunim më i ngushtë me publikun, të cilit i drejtohet ky Raport, duke vlerësuar se, një politikë më efikase e sigurisë dhe mbrojtjes, shkon paralelisht me një ndërgjegjësim më të lartë ndaj rreziqeve.

Me rastin e publikimit të Raportit të dytë Publik, Drejtori i SHISH, z. Helidon Bendo, u shpreh se, kontributi në fuqizimin e sigurisë kombëtare kalon edhe përmes rritjes së besimit të publikut te Shërbimi Informativ i Shtetit.

“Veprimtaria e shërbimeve jo-mike, kërcënimet terroriste, situata në rajon, krimi i organizuar, krimet në ekonomi dhe korrupsioni, kanë vijuar të jenë shqetësimet kryesore ndaj sigurisë kombëtare. SHISH-i ka përgatitur dhe ndarë produkt informativ analitik e operacional, në nivel qendror e lokal, me agjencitë ligjzbatuese e shërbimet partnere, duke dhënë kontribut të vlerësuar në parandalimin e goditjen e veprimtarive antiligjore“, tha Drejtori Bendo.

Raporti Publik 2019 mund të shkarkohet i plotë në formatin PDF, në variantin shqip dhe anglisht, në faqen www.shish.gov.al.